

LIGJ
Nr. 5/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCave, DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A. PËR
PROJEKTIN ME OBJEKT “STUDIME FIZIBILITETI, HARTIM DHE PLANIFIKIM NË
NIVEL PËRFUNDIMTAR DHE STUDIM TË NDIKIMIT MJEDISOR NË FUSHËN
E INFRASTRUKTURËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A. për projektin me objekt “Studime fizibiliteti, hartim dhe planifikim në nivel përfundimtar dhe studim të ndikimit mjedisor në fushën e infrastrukturës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.2.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi

MARRËVESHJE FINANCIARE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI
S.P.A. EURO 2.100.000,00**

“Projekti me objekt studime fizibiliteti, hartim dhe planifikim në nivel përfundimtar dhe studim të ndikimit mjedisor në fushën e infrastrukturës”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu e më poshtë referuar si “Huamarrësi”),

nga njëra anë,

dhe

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., me kapital aksionesh 4,051,143.264.00 euro, me seli në Romë, Via Goito 4, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive n. 80199230584, kodë fiskal n. 07756511007 (në vijim referuar si “CDP”), si administrator, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë i Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillim, i krijuar nga Qeveria e Italisë në vijim të nenit 26, të ligjit italian nr. 227, të datës 24 maj 1977, dhe më tej të referuara në nenin 8, të ligjit italian nr. 125, të datës 11 gusht 2014, ndryshuar here pas here, përfaqësuar nga z. Bernardo Bini Smaghi, Përgjegjës i Departamentit të Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar,

nga ana tjetër.

(CDP dhe Huamarrësi, së bashku, të referuar këtu e më poshtë si: “Palët”)

kanë vendosur të hyjnë në këtë

FINANCIAL AGREEMENT

**BETWEEN THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
REPRESENTED BY THE MINISTRY OF FINANCE AND CASSA DEPOSITI E
PRESTITI S.P.A. EURO 2.100.000,00**

“Project facility for feasibility studies, design and final level planning and environmental impact study in the field of infrastructures”

The Council of Ministers of the Republic of Albania represented by the Ministry of Finance (hereinafter referred to as the “Borrower”),

and

on one side,

Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., share capital Euro 4.051.143.264,00 with registered office in Rome, Via Goito 4, registered with the Companies Register n. 80199230584, Tax Code VAT n. 07756511007 (hereinafter referred to as “CDP”), as administrator, on behalf of the Ministry of Economy and Finance of the Italian Republic, of the Revolving Fund for Development Cooperation established by the Government of Italy pursuant to Article 26 of Italian Law no. 227 of May 24, 1977, and further referred to article 8 of Italian Law no. 125 of August 11th 2014, as amended from time to time, represented by Mr. Bernardo Bini Smaghi, Head of of International Development Cooperation Department on the other side.

(CDP and the Borrower together hereinafter referred to as the “Parties”) have decided to enter into this

MARRËVESHJE FINANCIARE

Neni 1

Përkufizime

Në marrëveshjen financiare dhe shtojcat e saj, termat e mëposhtëm kanë kuptimet si vijojnë:

- “Njohje e borxhit” do të thotë deklarimi, të cilit i bëhet referencë në nenin 11, me anë të së cilës Huamarrësi merr përsipër, në favor të CDP-së, të rimbursojë principalin në lidhje me kredinë e butë.
- “Marrëveshje” nënkupton këtë marrëveshje financiare, pjesën hyrëse dhe shtojcat të cilat janë pjesë përbërëse e saj.
- “AIZHB” nënkupton Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, themeluar sipas ligjit italian 125/14.
- “Llogaria CDP” nënkupton llogarinë (IBAN: IT06Z076020320000000000122 – Bic/Swift: CADPITRRXXX), e çelur nën emrin e “Cassa depositi e prestiti Società per azioni”.
- “Periudhë pa pagesë principali” do të thotë periudha që zgjat 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë.
- “Autoritetet kompetente italiane” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë dhe/ose çdo autoritet tjetër kompetent i Qeverisë së Republikës së Italisë, i emëruar për qëllime të kësaj marrëveshjeje;
- “MAECI-DGCS” do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë - Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.
- “MEF” do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë.
- “MTI” do të thotë Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për zbatimin e Programit.
- “MP” nënkupton Marrëveshjen e Programit të nënshkruar më 12 prill 2016, në Tiranë, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga MTI, për zbatimin e Programit.
- “Program” nënkupton “Projektin me objekt studime fizibiliteti, hartim dhe planifikim në nivel përfundimtar dhe studim të ndikimit mjedisor në fushën e infrastrukturës”, që do të financohet nga kredia e butë në përputhje me MP-në dhe këtë marrëveshje.
- “Kërkesë e datës së disbursimit” nënkupton datën e mbërritjes në CDP të kërkesës së disbursimit, të siguruar nga furnizuesi sipas formës të shtojcës B.
- “Hua e butë” nënkupton financimin që CDP, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë, do të jap në lidhje me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.
- “Llogari e veçantë” nënkupton llogarinë e hapur nga huamarrësi në Bankën e Shqipërisë, në të cilën CDP-ja do të disbursojë me një kësht të vetëm shumën prej 150.000,00 (njëqind e pesëdhjetë mijë /00) euro dhe që më pas transferohen në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, me qëllim lehtësimin e aftësisë për të punuar të njëjtit teknikë, siç parashikohet në MP.
- “Kontratë(a) furnizimi” do të thotë kontrata(t) në lidhje me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve ndërmjet MTI dhe furnizuesve lidhur me realizimin e programit.

FINANCIAL AGREEMENT

Article 1

Definitions

In the Financial Agreement and in the Annexes thereto, the following terms shall have the following meanings:

- “Acknowledgement of Indebtedness”: means the statement, referred to under Article 11, by means of which the Borrower undertakes, in favour of CDP, to reimburse the principal due with respect to the Soft Loan;
- “Agreement”: means this Financial Agreement, the preamble and the annexes hereto forming an integral part thereof;
- “AICS”: means the Italian Agency for Development Cooperation, established ex Italian law 125/ 14 ;
- “CDP account”: means the account (IBAN IT06Z076020320000000000122 - Bic/Swift CADPITRRXXX) opened under the name of Cassa depositi e prestiti Società per azioni;

- “Grace Period”: means the period, lasting 192 (one hundred ninety-two) months, beginning on the date of the first disbursement;
- “Italian Competent Authorities”: means the Ministry of the Economy and Finance, and/or the Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation of the Italian Republic and/or any other competent entity of the Government of the Italian Republic, nominated for the purpose of this Agreement;
- “MAECI-DGCS”: means the Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation of the Italian Republic - Directorate General for Development Cooperation;
- “MEF”: means the Ministry of Economy and Finance of the Italian Republic;
- “MTI”: means the Ministry of Transports and Infrastructures of the Republic of Albania, responsible for the Programme implementation;
- “PA”: means the Programme Agreement signed on April 12th, 2016 in Tirana between the Government of the Italian Republic, represented by the Ministry of Foreign Affairs and International Cooperation, and the Council of Ministers of the Republic of Albania, represented by the MTI, for the realization of the Programme;
- “Programme”: means the Project facility for feasibility studies, design and final level planning and environmental impact study in the field of infrastructures, to be financed through the Soft Loan in accordance with the PA and this Agreement;
- “Request of disbursement date”: means the date of arrival in CDP of the request of disbursement provided by the supplier in the form of Annex B);
- “Soft Loan”: means the financing that CDP, on the basis of the authorisation issued by the Ministry of Economy and Finance, and upon the proposal of the Ministry of the Foreign Affairs and International Cooperation of the Italian Republic, will grant on the terms and the conditions provided for in the Article 3 of this Agreement;
- “Special Account”: means the account opened by the Borrower at Bank of Albania on which CDP shall disburse in a single tranche the amount of Euro 150.000,00 (a hundred fifty thousand/00) and then transferred to a second level Bank of Albania aimed at allowing the ability to work of the Technical Unit, as set forth in the PA;
- “Supply Contract(s)”: means the contract(s) relating to the supply of goods and/or services between the supplier and the MTI connected to the realisation of the Programme.

Neni 2 Hyrje

2.1 Me anë të “Marrëveshjes së Programit”, të nënshkruar më 12 prill 2016, në Tiranë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga MAECI-DGCS, Qeveria e Republikës së Italisë është angazhuar të financojë programin nëpërmjet një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 2.100.000,00 eurosh (dy milionë e njëqind mijë/00).

2.2 Me anë të kësaj marrëveshjeje, palët synojnë të: i) të zbatojnë dispozitat financiare që lidhen me huan e butë, të parashikuara në nenin 8 të MP-së; dhe ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me MP-në.

2.3 MEF, me propozim të MAECI-DGCS, me dekretin nr. 52799, të datës 26 qershor 2012, dhe notës n. 53163, të datës 2 korrik 2015, ka autorizuar Artigiancassa S.p.A. t’i japë huamarrësit një kredi të butë në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje (në vijim të referuar si “Huaja e butë”), me qëllim financimin e programit. MEF, me notën n. 11140, të datës 3 shkurt 2016, ka autorizuar CDP të finalizojë marrëveshjen financiare në fjalë.

Article 2 Preamble

2.1 By means of the PA, signed on April 12th, 2016 in Tirana between the Council of Ministers of the Republic of Albania, represented by the MTI, and the Government of the Italian Republic, represented by MAECI-DGCS, the Government of the Italian Republic has committed itself to finance the Programme through a Soft Loan up to a maximum amount of Euro 2.100.000,00 (two million one hundred thousand/00).

2.2 By means of this Agreement the Parties intend to: (i) implement the financial provisions relating to the Soft Loan as contemplated in the Article 8 of the PA, and

(ii) regulate their rights and obligations in accordance with the PA.

2.3 The MEF, on the proposal of MAECI-DGCS, by decree no. 52799 dated June 26th 2012 and note n.

53163 dated July 02n<l, 201 5 has authorised Artigiancassa S.p.A. to grant to the Borrower a soft loan on the terms and conditions set forth in Article 3 of this Agreement (hereinafter referred to as the “Soft Loan”) for the purpose of financing the Programme. The MEF, by note n.1 1140 dated February 03r<l, 2016, has authorized CDP to finalize the relevant Financial Agreement.

Neni 3 Huaja e butë

3.1 CDP-ja i jep huamarrësit, dhe huamarrësi në këtë mënyrë pranon kredinë e butë sipas kushteve të mëposhtme:

- Shuma: 2.100.000,00 euro (dy milionë e njëqind mijë/00);
- Kohëzgjatja: 26 (njëzet e gjashtë) vjet;
- Periudhë pa pagesë principali: 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj, duke filluar nga data e disbursimit;
- Shlyerja: 20 (njëzet) këste të njëpasnjëshme të barabarta gjashtëmujore principali, i pari nga të cilët duhet paguar 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj pas disbursimit të parë;
- Norma e interesit: 0.00% në vit (zero pikë zero në vit);
- Qëllimi i kredisë: “Projekt me objekt studimet e fizibilitetit, projektimin dhe planifikimin në nivel përfundimtar dhe studimin e ndikimit mjedisor në fushën e infrastrukturave”.

3.2 Huaja e butë ndahet në dy komponentë:

1) 1.950.000,00 euro (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë/00), me qëllim financimin e tre studimeve të fizibilitetit, hartimin dhe planifikimin në nivel përfundimtar dhe studimin e ndikimit mjedisor në fushën e infrastrukturës;

2) 150.000,00 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë/00), me qëllimin financimin e aftësimit për punë të njesisë teknike në MTL.

3.3 Huaja e butë do të përdoret për të përftuar mallra dhe shërbime me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 35% (tridhjetë e pesë) për qind të kredisë së butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale.

Kontratat e furnizimit do të përcaktohen në euro.

3.4 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- mallra dhe shërbime të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi me aktivitetet ushtarake;
- artikuj luks;
- taksat jo mbi të ardhurat/jo nga fitimi (përfshirë TVSH-në) dhe tarifatat e importit;
- taksa vendore;
- provizionet për borxhet e papaguara dhe humbjet e ardhshme të përfituesit apo përdoruesve përfundimtarë;
- interesat që përfituesi apo përdoruesi përfundimtar i detyrohet çdo pale të tretë.

3.5 Huaja e butë është vënë në dispozicion në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje.

Article 3 Soft Loan

3.1 CDP grants to the Borrower, and the Borrower hereby accepts, the Soft Loan on the following conditions:

- Amount: Euro 2.100.000,00 (two million one hundred thousand/00);
- Duration: 26 (twenty-six) years;
- Grace period: 192 (one hundred ninety-two) months beginning on the date of the first disbursement;
- Repayment: 20 (twenty) consecutive equal deferred semi-annual principal instalments the first of which falling 192 (one hundred ninety-two) months after the first disbursement;
- Interest Rate: 0.00% p.a. (zero point zero p.a.);
- Credit Purpose: “Project facility for feasibility studies, design and final level planning and environmental impact study in the field of infrastructures”.

3.2 The Soft Loan shall be divided in two components:

1. Euro 1.950.000,00 (one million nine hundred fifty thousand/00) aimed at financing the three feasibility studies, design and final level planning and environmental impact study in the field of infrastructures;

2. Euro 150.000,00 (a hundred fifty thousand /00) aimed at financing the ability to work of the Technical Unit at the MTL

3.3 The Soft Loan shall be used for acquiring goods and services of Italian origin. A maximum amount

equal to the 35% (thirty-five) per cent of the Soft Loan may be used to cover local costs.

Supply contracts shall be denominated in Euro.

3.4 The Soft Loan cannot be used to finance:

- goods and services related, directly or indirectly to military activities;
- luxurious items;
- non income/non-profit taxes (including VAT) and import duties;
- local taxes;
- provisions for outstanding debts and future losses of the beneficiary or the final users;
- interests owed by the beneficiary or the final users to any third party.

3.5 The Soft Loan shall be available in accordance with the terms and conditions set forth in this Agreement.

Neni 4

Hyrja në fuqi e marrëveshjes financiare

4.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi CDP-ja të ketë marrë dokumentet e mëposhtme nga huamarrësi:

i) një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Shqipërisë, që dëshmon autoritetin e huamarrësit për të nënshkruar këtë marrëveshje, në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nga një person i autorizuar në pajtim në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Republikën e Shqipërisë dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje;

ii) një njoftim me shkrim nga huamarrësi për përmbushjen e procedurave të tij të brendshme;

iii) përcaktimin me shkrim nga autoriteti kompetent i huamarrësit (përmes Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipëri) të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar këtë marrëveshje, kërkesën për financimin e kontratës së furnizimit në formularin e shtojcës A), autorizimin e disbursimit në formularin e shtojcës C), kërkesën për disbursim në formularin e shtojcës D) dhe njohjen e borxhit në formularin e shtojcës F), referuar sipas nenit 11 më poshtë. Ky përcaktim do të specifikojë emrin dhe pozitën e këtij personi/këtyre personave dhe do të përmbajë ekzemplarin e nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim në të (nëse ka) do të transmetohet në kohë nga huamarrësi për CDP-në.

4.2 CDP-ja, pas pranimit dhe plotësimit tërësor të dokumenteve të lartpërmendura, do të njoftojë huamarrësin dhe AIZHB-në, me letër ose me faks, që do të konfirmohet më pas me shkresë, për datën në të cilën do të bëhet efektive kjo marrëveshje.

Article 4

Coming into effect of the Financial Agreement

4.1 This Agreement shall come into effect upon CDP having received the following documents from the Borrower:

i) a statement by the competent authority of the Government of Albania, evidencing the authority of the Borrower to sign, in the name and on behalf of the Government of the Republic of Albania, this Agreement by a duly authorised person pursuant to the laws and regulations in full force and effect in the Republic of Albania and to undertake the obligations arising out of this Agreement;

ii) a written notification by the Borrower of completion of its internal procedures;

iii) the appointment in writing by the competent authority of the Borrower (through the Italian Embassy in the Republic of Albania) of the person or persons duly authorised to sign this Agreement, the Request for financing of the supply contract in the form of Annex A), the disbursement authorisation in the form of Annex C), the request for disbursement in the form of Annex D) and the Acknowledgement of Indebtedness in the form of Annex F), referred to under Article 11 below. Such designation shall specify the name and the office of such person/s and contain the up to date "specimen form" of the signatures thereof. Any modifications thereof (if any) shall be transmitted in a timely manner by the Borrower to CDP.

4.2 CDP shall, upon receipt and full satisfaction of the aforementioned documents, notify to the Borrower and to AICS, by letter or fax to be subsequently confirmed by letter, the date on which this Agreement shall have come into effect.

Neni 5

Afati i disbursimit të huas së butë

5.1 Periudha e disbursimit të huas së butë do të përfundojë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të shtyhet nga CDP-ja. CDP-ja nuk mund të shtyjë periudhën e

disbursimit në rast se huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord për këtë shtyrje dhe kanë njoftuar për këtë me shkrim CDP-në të paktën 30 (tridhjetë) ditë para datës së përfundimit të periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka përfunduar dhe nuk mund të shtyhet më tej, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, CDP-ja do të informojë huamarrësin në lidhje me anulimin e angazhimit të CDP-së në lidhje me fondet e papërdorura.

Article 5

Term for the Disbursement of the Soft Loan

5.1 The disbursement period of the Soft Loan will expire 36 (thirty-six) months after the date of the first disbursement. Such period may be extended by CDP. CDP cannot extend the disbursement period in the event the Borrower or the Itali an

Competent Authorities disagree to such an extension and have so notified in writing CDP at least 30 (thirty) days before the expiry date of the disbursement period.

5.2 In the event that the disbursement period has expired and is not extendable, CDP, after having consulted with the Italian Competent Authorities, shall inform the Borrower of the cancellation of CDP's commitment relating to the unused funds.

Neni 6

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e shumës maksimale prej 1.950.000,00 euro

6.1 Huaja e butë mund të përdoret nga MTT-ja, në emër dhe për llogari të huamarrësit, pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

i) autorizim i dhënë nga autoritetet kompetente italiane për të alokuar kontratën /kontratat e furnizimit për huan e butë;

ii) rezultat i suksesshëm i verifikimit të kryer nga CDP-ja sipas nenit 6.2 (i) më poshtë;

iii) marrja e kërkesës nga ana e CDP-së për financimin e kontratës së furnizimit, parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Pas marrjes së autorizimit të përmendur sipas nenit 6.1 (i) më sipër, CDP-ja do të procedojë menjëherë si më poshtë:

i) të kryejë kontroll, mbi bazën e kërkesave të parashikuara nga autoritetet kompetente italiane mbi furnizuesin italian dhe mbi individët /kompanitë italiane (nëse ka) të përfshira në organizatën lokale dhe mbi kontratën/kontratave të furnizimit. Për sa i përket kontratës/kontratave të furnizimit, CDP-ja do të verifikojë që ato të jenë në përputhje me termat dhe kushtet e huas së butë dhe të jenë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme në lidhje me analizën kosto/çmime, me qëllim që të lejojë verifikimet e parashikuara në nenin 8.2;

ii) të njoftojë MTT-në, në emër dhe për llogari të huamarrësit, mbi marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1 i) më sipër dhe të kërkojë nga MTT-ja që të përcjellë kërkesën e parashikuar sipas nenit 7.1.

6.3 Rezultati i suksesshëm i verifikimit të kryer nga CDP-ja sipas nenit 6.2 (i) më sipër do të shkaktojë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit për huan e butë. Financimi i kontratës/kontratave të furnizimit do të kryhet vetëm pas plotësimit në mënyrë të kënaqshme të kushtit të përcaktuar në nenin 6.1 (iii).

6.4 CDP-ja do të njoftojë me anë të një letre ose faksi MTT-në në emër dhe për llogari të huamarrësit, AIZHB dhe furnizuesit e alokimit, si dhe financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Article 6

Conditions and modalities for the disbursement of the maximum amount of Euro 1.950.000,00

6.1 The Soft Loan may be used by the MTT, in the name and on behalf of the Borrower, upon satisfaction of the following conditions:

i) authorisation granted by the Italian Competent Authorities to allocate the Supply Contract/s to the Soft Loan;

ii) successful result of the inquiry made by CDP according to Article 6.2 (i) below;

(iii) CDP's receipt of the request for financing of the supply contract provided for by Article 7.1 below.

6.2 Upon receipt of the authorisation mentioned under Article 6.1 (i) above, CDP shall immediately proceed as follows:

i) to make the control, on the basis of the requirements provided for by the Italian Competent Authorities, over the supplier and over Italian individuals/companies (if any) involved with the local organisation and over the Supply Contract/s. With respect of the Supply Contract/s CDP shall verify that they are in compliance with the terms and conditions of the Soft Loan and that they are sufficiently detailed with regard to

costs/prices breakdown, in order to permit the inquiries provided for under Article 8.2;

ii) to notify the MTI, in the name and on behalf of the Borrower, of the acquisition of the authorisation under Article 6.1 i) above and to require the MTI to forward the request provided for under Article 7.1.

6.3 The successful result of the inquiry made by CDP as per Article 6.2 (i) above will cause the allocation of the Supply Contract/s to the Soft Loan. The financing of the Supply Contract/s shall only take place upon the satisfaction of the condition set forth under Article 6.1 (iii).

6.4 CDP shall notify by letter or fax the MTI, in the name and on behalf of the Borrower, AICS and the supplier of the allocation as well as the financing of the Supply Contract/s.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit për t'u disbursuar sipas komponentit të huas së butë prej 1.950.000,00 euro

7.1 Pas njoftimit në lidhje me rezultatin e suksesshëm të verifikimit sipas nenit 6.2 (i), MTI, në emër dhe për llogari të huamarrësit do t'i transmetojë CDP-së një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit, të nevojshme për pagesat e parashikuara në secilën kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkesë, e cila do të jetë sipas formularit të shtojcës A), huamarrësi do të vërtetojë se kontrata e furnizimit është e pranueshme për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë CDP-së shumën e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit e parashikuar në nenin 7.1 do të merret në kohën e duhur dhe në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj nga data e njoftimit nga CDP-ja, parashikuar në nenin 6.4 më sipër ose afatin (nëse ka), të parashikuar në kontratën e furnizimit. Pas përfundimit të periudhës së sipërpërmendur, pas konsultimit me autoritetet kompetente italiane, CDP-ja do të shqyrtojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit, të alokuar për huan e butë.

Article 7

Request for financing of the Supply Contract to be disbursed under the Soft Loan component of Euro 1.950.000,00

7.1 After the notification of the successful result of the inquiry according to Article 6.2 (i), the MTI, in the name and on behalf of the Borrower, shall transmit to CDP a letter of request for financing of the Supply Contract necessary for the payments provided for in each Supply Contract. By means of such request, which shall be in the form of Annex A), the Borrower shall acknowledge that the Supply Contract is eligible to be financed and shall undertake to reimburse CDP the amount disbursed.

7.2 The letter of request for financing of the Supply Contract provided for under Article 7.1 shall be received in a timely manner and in no event later than six months from the date of the notice by CDP provided for under Article 6.4 above or the term (if any) provided for in the Supply Contract. After expiration of the above mentioned period, CDP shall consider, after consultation with the Italian Competent Authorities, the possible cancellation of the Supply Contract/s allocated to the Soft Loan.

Neni 8

Procedura e disbursimit për shumën maksimale prej 1.950.000,00 euro

8.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë CDP-së origjinalin e dokumentacionit kontraktual dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse të CDP-së, në përputhje me kontratën e furnizimit, sipas formularit të shtojcës B) që do t'i dërgohen nga një kopje huamarrësit dhe MTI-së. Kopja origjinale e lartpërmendur e dokumentacionit kontraktual duhet të dërgohet nga CDP-ja për huamarrësin dhe një kopje për MTI-në.

8.2 Pas pranimit të çdo kërkesë disbursimi, CDP-ja i komunikon MTI-së dhe një kopje huamarrësit kërkesën e datës së disbursimit dhe do të rishikojë dokumentacionin kontraktual. Ky rishikim do të përfshijë pajtueshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën përkatëse të furnizimit.

8.3 CDP-ja do të disbursojë vetëm pas autorizimit të pagesës së MTI-së, duke vepruar në emër dhe për llogari të huamarrësit, sipas formularit të shtojcës C). Ky autorizim i pagesës do t'i dërgohet CDP-së brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e kërkesës së disbursimit.

8.4 Në bazë të verifikimit të suksesshëm të parashikuar në nenin 8.2 më sipër, CDP-ja i konfirmon me letër ose faks MTI-së dhe huamarrësit shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën janë kredituar fondet.

8.5 CDP-ja do të kryejë pagesat në favor të furnizuesit/ve dhe do të marrë nga ky furnizues/këta furnizues faturën e lëshimit, të parashikuar në shtojcën E në dy origjinale, njëri prej të cilëve mbahet në MTI dhe një kopje për huamarrësin.

8.6 Pas çdo pagese në favor të furnizuesit /furnizuesve, CDP do t'i dërgojë me shkrim huamarrësit dhe një kopje MTI-së një program shlyerjeje të shumës së disbursuar, duke cilësuar datat e maturuara në lidhje me

të, në përputhje me nenin 10 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin nga ana e tij të programit të mësipërm të shlyerjes.

Article 8

Disbursement procedure for the maximum amount of Euro 1.950.000,00

8.1 The supplier shall deliver the original Contractual Documentation to CDP, and shall request the disbursement of the relevant amount to CDP, in compliance with the Supply Contract, in the form of Annex B), that shall be sent in copy to the Borrower and MTI. The above-mentioned original copy of the Contractual Documentation shall be sent by CDP to the Borrower and copy to the MTI.

8.2 Following the receipt of each request of disbursement, CDP shall communicate to the MTI and in copy to the Borrower the request of disbursement date and shall review the Contractual Documentation. Such review shall include compliance of the Contractual Documentation with the relevant Supply Contract.

8.3 CDP shall disburse only after the authorization of payment of MTI, acting in the name and on behalf of the Borrower, in the form of Annex C). This authorization of payment shall be sent to CDP within 30 (thirty) calendar days from the request of disbursement date.

8.4 Subject to the successful inquiry provided for in Article 8.2 above CDP shall confirm by letter or fax to the MTI and the Borrower the total amount of the disbursement and the date on which the funds have been credited.

8.5 CDP shall make the payments in favour of the supplier/s and shall obtain from such supplier/s the discharge receipt provided for in Annex E) in two originals, one of which shall be remitted to the MTI and in copy to the Borrower.

8.6 Following each payment in favour of the supplier/s, CDP shall send in writing to the Borrower and in copy to the MTI a repayment schedule which states the amount disbursed indicating the due dates relating thereto in compliance with Article 10 below. The Borrower shall confirm in writing its acceptance of the above mentioned repayment schedule.

Neni 9

Procedura e disbursimit për shumën maksimale prej 150.000,00 euro

9.1 Shuma prej 150.000,00 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë/00), e cila synon financimin e aftësisë për punë të njësisë teknike në MTI do të disbursohet nga CDP-ja pas:

- i) hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje;
- ii) komunikimit të MTI-së për CDP për hapjen e llogarisë së veçantë.

9.2 Kërkesa e disbursimit e transmetuar nga MTI-ja, në emër dhe për llogari të huamarrësit, në pajtim me shtojcën D), për shumën prej 150.000,00 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë/00) do të ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh, duke filluar nga data e marrjes së kërkesës nga CDP-ja.

9.3 Brenda 24 (njëzet e katër) muajsh nga data e disbursimit, MTI-ja, në emër dhe për llogari të huamarrësit, do t'i dërgojë AIZHB-së dhe CDP-së, dhe në kopje huamarrësit, një raport financiar në lidhje me rregullsinë dhe pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në MP dhe në këtë marrëveshje të çdo transaksioni financiar që lidhet me shumën e disbursuar. AIZHB dhe CDP-ja do të informojnë MTI-në, dhe në kopje huamarrësin për rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditësh kalendarike nga data marrjes së raportit financiar.

9.4 Huamarrësi merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme të rimburojë CDP-në në shumën të barabartë me shpenzimet e pamiratuara nga AIZHB-ja dhe CDP-ja.

9.5 Nëse ndonjë shumë e kredituar MTI-së nga CDP-ja nuk do të përdoret brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, kjo shumë do t'i kthehet menjëherë CDP-së nga MTI-ja, në emër dhe për llogari të huamarrësit. Ky transferim do të bëhet pa vonesë pas komunikimit që është rënë dakord nga AIZHB, nga CDP-ja të huamarrësi dhe MTI-ja dhe me të gjitha mjetet, brenda një muaji nga komunikimi CDP.

9.6 Pas disbursimit të fondeve në llogarinë e veçantë, CDP-ja i transmeton me anë të një letre huamarrësit dhe në kopje MTI-së programin përkatës të shlyerjes, duke cilësuar datat e detyrueshme në lidhje me të. Ky plan shlyerjeje, që do të plotësohet në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 10 më poshtë, do të pranohet me shkrim nga huamarrësi.

Article 9

Disbursement procedure for the maximum amount of Euro 150.000,00

9.1 The amount of Euro 150.000,00 (a hundred fifty thousand/00) aimed at financing the ability to work

of the Technical Unit at the MTI, shall be disbursed by CDP after

- i) the entry into force of this Agreement;
- ii) the communication from MTI to CDP about the opening of the Special account.

9.2 The Request of Disbursement, transmitted by the MTI, in the name and on behalf of the Borrower, in accordance with Annex D), for the amount of Euro 150.000,00 (a hundred fifty thousand/00), shall be executed within 30 (thirty) days starting from the date of receipt of the request by CDP.

9.3 Within 24 (twenty-four) months from the date of the disbursement, MTI, in the name and on behalf of the Borrower, will send to AICS and CDP, and in copy to the Borrower, a financial report concerning the regularity and compliance to the conditions set up in the PA and in this Agreement of every financial transaction relating to the amount disbursed. AICS and CDP shall inform the MTI, and in copy the Borrower, about the results of the verification within 20 (twenty)-calendar days from the receipt date of the financial report.

9.4 The Borrower irrevocably undertakes to refund to CDP the amounts equal to the expenditures not approved by AICS and CDP.

9.5 If any amount credited to the MTI by CDP will not be utilised within 24 (twenty four) months from the date of the disbursement, that amount shall be, immediately, refunded to CDP by the MTI, in the name and on behalf of the Borrower. Such transfer shall be made out without delay after the communication, agreed with AICS, by CDP to the Borrower and MTI, and by all means, within a month from CDP's communication.

9.6 After the disbursement of funds to the Special Account, CDP shall transmit by letter to the Borrower and copy to the MTI, the related repayment schedule, indicating the due dates relative thereto. Such repayment schedule, completed in accordance with the conditions set forth in Article 10 hereafter, shall be accepted by the Borrower in writing.

Neni 10

Shlyerja e huas së butë

10.1 Çdo shumë e disbursuar do të shlyhet sipas grafikut të shlyerjes në 20 (njëzet) këste gjashtëmujore të njëpasnjëshme të barabarta (më poshtë referuar si “Këstet e principalit”), i pari i të cilëve duhet të paguhet 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) muaj pas datës së disbursimit të parë. CDP-ja do t'i dërgojë huamarrësit grafikun e shlyerjes në përputhje me nenet 8.6 dhe 9.6.

10.2 Në lidhje me këstet e paguara të principalit efektivisht të kredituara, interesi i shtyrë do të llogaritet me një përqindje vjetore nominale prej 0.00% (zero pikë zero për qind).

10.3 Huamarrësi merr përsipër të kryejë pa vonesë të gjitha shlyerjet sipas kësaj marrëveshjeje dhe sipas njohjes së borxhit: në datën aktuale të maturimit për shumën korresponduese në euro, në favor të CDP-së ose personit/personave të autorizuar për këtë. Këto shuma do të kreditohen pa zbritje të ndonjë banke dhe/ose tarife shkëmbimi valutor dhe/ose taksa, dhe pa qenë e nevojshme njoftim në lidhje me këtë nga CDP-ja ose personat e autorizuar. Huamarrësi do të marrë një njoftim para datës së maturimit të shlyerjes. Nëse Huamarrësi, për çfarëdo arsye, nuk e merr njoftimin e sipërpërmendur, do të ndërmarrë gjithsesi të kryejë pa vonesë të gjitha shlyerjet e përcaktuara në grafikun e shlyerjes. Për çdo shlyerje, huamarrësi do t'i tregojë CDP-së numrin e marrëveshjes financiare dhe shumën totale të huas së butë dhe do të specifikojë për çdo datë maturimi shumat e paguara.

Article 10

Repayment of the Soft Loan

10.1 Each amount disbursed shall be repaid according to the repayment schedule in n.

